

## **Konsultimet Rajonale për draftin e Statutit të KOMRA-së**

**18. shtator 2010.  
Sarajevë, BeH**

**Komentet e pjesëmarrësve/eve:**

### **PJESA E I-rë–PERKUFIZIMI**

### **PJESA E II-të –E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1.**

#### **Përkufizimi i Koalicionit**

Komisioni rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të drejtave të njeriut në hapësirat e ish RSFJ-së, është organizatë rajonale ndërkombëtare e formuar nga shtetet të dala pas shpërbërjes së ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë me qëllim të përcaktimit të fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të drejtave të njeriut të kryera në luftërat në hapësirat e ish Jugosllavisë nga periudha 1 janar 1991 deri me 31. dhjetor vitit 2001.

**Komentet:**

*Pra, vitin 2004 e kemi hekë. A ka pasë shkelje të drejtave të njeriut në vitin 2004 në Kosovë dhe atë nën mbrojtjen e Kombeve të Bashkuara?* (Dragislav Mijanović, përfaqësues i Shoqatës së invalidëve ushtarak të Komunës së Zvornikut, BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

### **PJESA E V-të– ANËTARËT DHE ANËTARET TË KOMRA-s**

#### **Neni 10.**

#### **Përbërja e KOMRA-s**

[Opsioni A– rekomandim i Grupit punues]

KOMRA përbehet nga 20 anëtar apo anëtare siç janë:

- a. Bosnja dhe Hercegovina zgjedh pesë anëtarë apo anëtare;
- b. Kroacia, Kosova, Serbia zgjedhin nga tre anëtarë apo anëtare;
- c. Mali Zi, Maqedonia dhe Sllovenia zgjedhin nga dy anëtarë/anëtare.

[Opsioni B]

KOMRA përbehet nga 21 anëtar, ku secili shtet kontraktues zgjedh nga tre anëtarë/anëtare

**Komentet:**

*Nuk ka mundësi opsioni B, Por kuptim ka opsioni A, sepse opsioni A, (...) shkon në shtete ku kanë ndodhë krimet më të mëdha të luftës. Unë nuk mund të lejoj, (...) që tani nga Serbia të jetë numri i njëjtë i anëtarëve si ai nga Bosna e Hercegovina, nuk ka shans, (...) Sipas meje opsioni A është më i miri, me atë që ndoshta **Serbisë t'i zvogëlohet numri për një anëtarë, pra jo tre por dy anëtarë.** (Alia Hoxhiq, SHOqata e fëmijëve të vrarë në Sarajevës së rrethuar nga '92 deri '95, v; Sarajevë, BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)*

*(..) Ju e dini se Bosna e Hercegovina dhe Serbia nuk e kanë pranuar **Kosovën. Ajo është provincë e Republikës së Serbisë.** Nuk mundet ajo ti ketë tre anëtarë si Kroacia dhe Serbia ndërsa askush nga Republika Serpska, të cilën as Bosna nuk e ka pranuar, nuk do ta pranojë atë si republikë (...). (Dragislav Mijanoviq, përfaqësues i Shoqatës së invalidëve ushtarak të Komunës së Zvornikut, BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)*

*Personalisht, e **preferoj variantin A**, për arsye se kur mendohet mirë për të gjitha konfliktet, për luftërat, Bosna ka qenë në qendër të luftërave, me numër të madh të viktimave dhe si shtet kompleks ku I kemi të tri komponentët boshnjake, kroate dhe serbe. (Drago Kovaqeviq, forumi demokrat serb, Beograd, Serbi, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)*

*Mendoj se do të duhej të ishte 21 apo 23, pra të jetë numër tek, që të mos vihet deri të barazimi, ashtu që të mund të vihet deri të përfundimi dhe rezultati. Të mos shkohet në 50 por në 79 **Përqind për votim në zgjedhjen përfundimtare.** (Lush Krasniqi, anëtar i familjes së viktimave, Gjakovë, Kosovë, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)*

*(...) në Mal të Zi (...) janë më se 15.400 persona të përndjekur nga Kosova dhe Metohia (...) dhe rreth 3.500 refugjatë. Prandaj, kurrë nuk mund të jetë njëjtë dhe të jenë numër i njëjtë i anëtarëve nga Mali i Zi, Maqedonia dhe Sllovenia. Mendoj se këtu do të duhej të jetë një përfaqësues i shoqatës, i cili e njeh tërë situatën, edhe familjet edhe të zhvendosurit, dhe do të ishte mirë që në mesin këtyre dy personave të jetë edhe një person nga shoqata, apo të shtohet*

*edhe një për këtë (...).* (Lubisha Filipović, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve, të zhdukurve dhe të vrarëve gjatë viteve '1998 deri 1999, në territorin e Kosovës dhe Metohisë, Bozhuri i kuq, Mali i Zi, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

*(...) unë e propozoj opsionin A, kur është në pyetje Bosna dhe Hercegovina.* (Murat Tahiroviq, kryetar i Asociacionit të të përndjekurve të kampeve të përqendrimit, Sarajevë, BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

*Mendoj se opsioni B është më i mirë, sepse mendoj se të gjitha shtetet do të duhej të kenë numër të njëjtë (të anëtarëve në KOMRA).* (Hysni Berisha, Shpresimi, Suha Rekë, Kosovë, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

*(...) numri 20 nuk është i përshtatshëm, sepse e kemi thënë në njërin nga nenet e mëparshme se vendimet merren me dy të tretat (...) Megjithatë, numri 21 nuk është i mirë sepse vlerësoj se kemi detyra dhe qëllime shumë të ndërlikuara prandaj mendoj se më i afërt është numri 24 apo 25.* (Amir Kulagliq, Gratë e Srebrenicës, Srebrenicë, BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

## **Neni 12.**

### **Kriteret e përzgjedhjes anëtarëve/anëtareve të KOMRA-s**

1. Anëtarët apo anëtares të KOMRA-s janë shtetas apo shtetase të shteteve palë.
2. Anëtarët dhe anëtares janë persona me karakteristika të moralit, integritetit dhe të reputacionit të lartë, të dedikuar dialogut tolerancës dhe zgjidhjes konstruktive të konflikteve, të cilët mund të gëzojnë besimin e popullit në të gjithë shtetet palë.
3. Anëtarët dhe anëtares të KOMRA-s duhen të janë psikofizik të aftë dhe të kanë diplomë universitare.

#### **Komentet:**

*Mendoj se kjo "fizike" nuk duhet të jetë kriter për anëtarësim. Mendoj se barriera fizike nuk duhet të jetë pengesë, apo që personi duhet të jetë i diplomuar, sepse me këtë ne po i largojmë njerëzit të cilët janë humanist, e që ndoshta nuk kanë arsimim të lartë.* (Lush Krasniqi, anëtar i familjes së viktimave, Gjakovë, Kosovë, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

*Mua më ofendon fakti që në këtë statut (draft) thuhet se njerëzit në KOMRA duhet të jenë me arsimim të lartë. Çka do të thotë kjo? Sipas meje, do të thotë se pjesa tjetër e njerëzve janë të*

**çmendur, budalla, të padijshëm.** (Alia Hoxhiq, Shoqata e fëmijëve të vrarë në Sarajevës së rrethuar nga '92 deri '95, v; Sarajevë, BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

### **Neni 13.**

#### **Procedura e zgjedhjes së anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-s**

1. Secili shtet palë duhet t'i zgjedhë anëtarët dhe anëtare në KOMRA sipas procedurës së përshkruar në këtë rregullore.
2. Kandidati dhe kandidatja për anëtarë dhe anëtare në KOMRA mund të propozohet nga organizatat jo-profitabile dhe subjektet ligjore ose nga 30 qytetarë të shtetit palë.
3. Procedurën e kandidimit e zbaton Paneli seleksionues, i cili i pranon kandidaturat, shqyrton nëse ato i plotësojnë kushtet e parapara dhe krijon listën e ngushtë të kandidatëve, numri i të cilëve duhet të jetë dy deri tre herë më i madh se numri i anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-s që zgjidhen në shtetin përkatës. Paneli seleksionues ia paraqet listën kryetarit/kryesisë së shtetit palë, i cili e bën përzgjedhjen përfundimtare.
4. a. Paneli seleksionues ka nëntë anëtarë, të cilët duhet t'i plotësojnë të njëjtat kushte që vlejnë edhe për anëtarët dhe anëtare të KOMRA-s, më përjashtim të ndalimit të anëtarësimit për politikanët dhe bartësit e funksioneve publike apo personat që kanë qenë në këto funksione gjatë periudhës kohore për të cilën KOMRA ka mandat.  
b. Anëtarët e Panelit nuk mund të jenë kandidatë për anëtarësim në KOMRA.  
c. Tre anëtarë emërohen nga Ministri për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicave Etnike apo Ministri i Drejtësisë, në konsultim me Komisionin parlamentar për të drejtat e njeriut. Anëtarët e Koalicionit për KOMRA nga shtetet palë emërojnë tre anëtarë të Panelit seleksionues. Kështu, anëtarët e zgjedhur bëjnë përzgjedhjen e tre anëtarëve tjerë, në bazë të konkursit të shpallur në afat prej tetë (8) ditëve nga dita e konstituimit të 2/3 së anëtarësisë të Panelit seleksionues.

#### **Komentet:**

**Ministria e drejtësisë së Bosnë e Hercegovinës nuk mundet t'i sjellë vendimet pa Republikën Serpska dhe Federatën. Dhe, afati është i shkurtë.** (Dragislav Mijanović, përfaqësues i Shoqatës së invalidëve ushtarak të Komunës së Zvornikut, BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

### **Neni 14.**

#### **Pjesëmarrja e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë**

Më rastin e zgjedhjes së anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-s, shtetet do të përpiqen që përbërja e Komisionit të jetë gjithëpërfshirëse, kështu që përpos pjesëtarëve të grupit më të madh etnik të përfshihen edhe pjesëtarët e komuniteteve tjera që jetojnë në atë shtet.

**Komentet:**

*Propozoj që të ndërrohet termi “do të tentojë” me termin “obligohet”. ’ (Milan Reljiq, përfaqësues i familjeve të viktimave, Shoqata Strugë, Biosanska Grahovë, BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)*

*Do ta marrë shembullin e Malit të Zi. Duhet të jenë dy ose tre anëtarë nga Mali i Zi. Nëse do të ishin të nacionalitetit malazez, do të kuptohej se në Malin e Zi viktimat janë vetëm të nacionalitetit malazez, e jo edhe boshnjakë, shqiptarë apo tjerë. Pra, duhet të angazhohemi që të jetë **përfaqësim reprezentativ** i cili në mënyrë objektive do ta shikojë nivelin e krimit, por edhe të viktimave në trevat e veçanta. (Amir Kulagliq, Gratë e Srebrenicës, Srebrenicë, BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)*

**Neni 20.**

**Detyrat e KOMRA-s**

Me qëllim që t'i vërtetoj faktet për luftërat/konfliktet e armatosura dhe për krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut, KOMRA ka për detyrë që:

1. të grumbullojë informacione dhe të ofrojë përshkrim të detajuar të rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut, respektivisht krimeve të luftës (individuale dhe në masë);
2. të grumbullojë të dhëna për fatin e personave të zhdukur dhe të bashkëpunojë me organet kompetente që merren me kërkimin e personave të zhdukur në shtetet palë;
3. të bëj regjistrimin e humbjeve njerëzore:
  - a. civilëve që kanë humbur jetën apo janë zhdukur, si pasojë e konflikteve të armatosura;
  - b. luftëtarëve që kanë humbur jetën apo janë zhdukur, si pasojë e konflikteve të armatosura/luftërave;

**Komentet:**

*Viktimat janë civilët të cilët nuk kishin armë, të cilët nuk ishin të armatosur, dhe mendoj se KOMRA në raportin e saj, në strategji duhet të vendos dy gjëra – viktimat dhe luftëtarët, sepse **luftëtarët nuk mund të jenë viktima**. Ata kanë pas armë, kanë shkuar në luftë, janë vrarë, e kjo është tjetër. (Munira Subashiq, Shoqata Nënata e enklavave nga Zhepa dhe Srebrenica, Sarajevë,*

BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

## PJESA E VII-të – AUTORIZIMET E KOMRA-s

### Neni 23.

#### Marrja e deklaratave

1. KOMRA është e autorizuar të marrë deklarata nga viktimat, dëshmitarët dhe qytetarët tjerë, për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut që janë në kompetencë të saj.
2. Deklaratat do të merren:
  - a. në vendbanimin e personit që e jep deklaratën;
  - b. në zyrat e KOMRA-s;
  - c. në ambasadat dhe konsullatat e shteteve palë në marrëveshjen për themelimin e KOMRA-s, në rast se deklarata merret në një shtet të tretë;
  - d. në territoret e shteteve të treta, nëse kjo nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të këtyre shteteve (në rastet kur viktimat, dëshmitarët dhe personat tjerë nuk mund t'i japin deklaratat në konsullatat dhe ambasadat e shteteve palë).

#### Komentet:

*Kërcënimet dhe vrasjet e qytetarëve bëjnë që ata nuk guxojnë të flasin, frikësohen se (...) Këtë pikë do të duhej ta zgjerojmë, të gjejmë se cila metodë është efiçase, cili është motive që dëshmitarët të flasin dhe cila është mënyra që të sigurojmë ata përmes organeve shtetërore se do të mbrohen dëshmitarët, për sigurinë e tyre personale, për sigurinë materiale, apo për sigurinë e anëtarëve të familjeve të tyre.* (Milosav Stojković, Qendra për mbrojtjen e familjeve të viktimave të luftës në KiM, Beograd, Serbi, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

### Neni 24.

#### Grumbullimi i dokumentacionit nga burimet tjera

KOMRA është e autorizuar të grumbullojë të dhëna relevante të shkruara, elektronike dhe materiale, siç janë:

- a. dokumentacionet e institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare dhe vendore, të cilat janë grumbulluar me qëllim të dokumentimit të krimeve të luftës, gjetjes së kryesve, zbardhjes së fatit të personave të zhdukur apo për çfarëdo arsye tjera;

- b. informacionet e shtypura dhe elektronike të huaja dhe vendore (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në dokumentacionin e qeverive, kuvendeve, kryesive, vetëqeverisjeve lokale dhe territoriale, ndërmarrjeve publike dhe private, ushtrive, policive, shërbimeve të sigurimit dhe shërbimeve informative);

**Komentet:**

*Duhet ta gjejmë mënyrën se si institucionet, nuk dua të them ti detyrojmë, sepse kjo është fjalë e rëndë, por a gjejmë mënyrën e bashkëpunimit me institucionet që të na i hapin dosjet. Në ato dosje qëndrojnë shumë gjëra.* (Milosav Stojković, Qendra për mbrojtjen e familjeve të viktimave të luftës në KiM, Beograd, Serbi, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

- a. aktvendimet e gjykatave, transkriptet, procesverbalet gjyqësore të Tribunalit Ndërkombëtar për Krime të Luftës për ish- Jugosllavinë, gjykatave nacionale të shteteve palë dhe gjykatave tjera që kanë gjykuar individë të akuzuar për krime lufte të kryera në territoret e ish-Jugosllavisë, të bazuar në kompetencat universale;
- b. arkivat tjera (ku përfshihen edhe certifikatat e vdekjes, raportet nga morgu dhe të tjera);
- c. të dhënat nga mediat e shkruara dhe elektronike;
- d. fotot, videot dhe audio incizimet;
- e. burimet tjera që kanë të bëjnë me objektin e hulumtimit;
- f. opinione të shkruara të ekspertëve dhe përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave, të përgatitura për nevojat e KOMRA-s.

**Neni 27.**

**Mbajtja e dëgjimeve publike të viktimave dhe personave tjerë**

1. KOMRA organizon dëgjime publike përmes të cilave viktimat mund ta njoftojnë publikun më të gjerë për vuajtjet e tyre dhe të afërmeve të tyre. Dëgjimet publike të dëshmitarëve bëhen në baza vullnetare.
2. Në kuadër të dëgjimeve publike mund të dëgjojnë edhe dëshmitarët e krimeve të luftës, respektivisht dëshmitarët e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, kryesit e krimeve të luftës apo shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe personat që u kanë ndihmuar viktimave apo që me veprimet e veta u kanë mundësuar njerëzve që të mos jenë viktimat e krimeve të luftës, respektivisht viktimat të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.
3. Gjatë dëgjimeve publike KOMRA mund të marrë masa për mbrojtjen e identitetit, sikurse edhe masa të posaçme për mbrojtjen e integritetit psikik dhe fizik të personit që dëshmon.

4. Mediat elektronike në pronësi të shtetit, respektivisht mediumet publike në hapësirat e ish RSFJ-së, kanë për detyrë t'i emitojnë dëshmitë publike. Mediat elektronike komerciale kanë të drejtë t'i emitojnë dëshmitë publike, me të njëjtat kushte dhe rregulla që vlejné edhe për mediat në pronësi shtetërore, respektivisht mediumet publike.
5. Dëgjimet publike mund të mbahen në vende të ndryshme.

**Komentet:**

*(...) mendoj se është njerëzore dhe se do të duhej tua japim shansin edhe kryesve të veprave të paraqiten para KOMRA-së (...) duhet t'ua japim shansin dhe mundësinë që edhe ata të vinë para KOMRA-së.* (Amir Kulagliq, Gratë e Srebrenicës, Srebrenicë, BeH, Žene Srebrenice, Srebrenica, BiH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

**Neni 34.**

**Përmbajtja e Raportit përfundimtar**

1. Raporti do ta ketë hyrjen, faktet relevante për luftërat/konfliktet e armatosura, krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, regjistrin e njerëzve të vrarë, regjistrin e personave të zhdukur, regjistrin e vendndodhjes së llogoreve dhe rekomandimet.
2. Rekomandimet e KOMRA-s, mes tjerash, përfshijnë:
  - a. hapat e mëtutjeshëm që duhet të ndërmarrin shtetet nënshkruese të kësaj marrëveshje për rritjen e besimit në mes shteteve dhe komuniteteve në hapësirat e ish-Jugosllavisë;
  - b. modelin e duhur për zhdëmtim material dhe simbolik, mënyrën e reformimit të institucioneve dhe mekanizmat përmes së cilëve sigurohet përfshirja e fakteve të konstatuara në sistemet arsimore të shteteve palë, në përputhje me Parimet dhe udhëzimet themelore për të drejtën në mjet juridik dhe zhdëmtim për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të miratuar përmes Rezolutës së Kuvendit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, numër 60/147, më 16 dhjetor të vitit 2005;
  - c. mënyrën e përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve të KOMRA-s, duke përfshirë edhe themelimin e organeve të posaçme për këtë qëllim.

**Komentet:**

*Mendoj, se KOMRA do ta bëjë një gabim të madh nëse në raportin e saj përfundimtar nuk do ta shkruante edhe hyrjen, e në hyrje do të shkruhet qartë terminologjia apo shprehjet **çka nënkupton KOMRA me termin viktimë në kuptimin e gjerë të fjalës**. Në nenin 22, ne e kemi cekë se cilat vepra dhe krime do ti hulumtojmë, por në përputhshmëri me këtë duhet ti klasifikojmë viktimat. Nëse do të kufizohemi vetëm në viktimat civile dhe ushtarake apo vetëm në*



të vrarët dhe të zhdukurit, mendoj se do ta bënim një padrejtësi të madhe ndaj një grupi të madh njerëzish të cilët i kanë përjetuar format tjera të shkeljeve të të drejtave të tyre, e ato janë dhunimet, arrestimet e dhunshme, maltretimet psikike dhe fizike (...) atë që ndoshta po e humbim nga vëmendja është se KOMRA do ta përfundojë punën e saj më raport, ku **në pjesën përfundimtare të raportit duhet të jenë rekomandimet**. Kjo do të thotë se është shumë me rëndësi që në rekomandime të ceken ligjet (nga fusha e drejtësisë tranzicionale) të cilët veç se janë miratuar në territorin e ish RSFJ-së, por edhe **mekanizmat konkret të shqyrtuar se sit ë fillohet ët zbatohen ato ligje**. (Amir Kulagliq, Gratë e Srebrenicës, Srebrenicë, BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

#### **Neni 35.**

#### **Karakteri i gjetjeve të KOMRA-s**

1. KOMRA nuk paraqet organ gjyqësor dhe rrjedhimisht nuk e përcakton përgjegjësinë penale individuale për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.
2. Pavarësisht nga kufizimet e cekura në paragrafin paraprak, KOMRA ka autorizim që në Raportin përfundimtar të konstatojë, në bazë të fakteve të grumbulluara, se personi i caktuar ka kryer krime lufte, respektivisht shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Kjo gjetje nuk e ka efektin e aktvendimit gjyqësor.

#### **Komentet:**

(...) ky formulim, mund të mbetet kështu. Secili qytetar është i obliguar ta raportojë (paraqesë) kryesin e veprës kriminale. Prandaj, KOMRA nuk do ta ketë kompetencën të thotë se ai e ka kryer veprën penale, por të tregojë për të gjitha të gjeturat për atë person, se të gjitha tregojnë se ai person e ka kryer veprën penale. (Dragan Pjevaq, Shoqata e familjeve të të vrarëve dhe të zhduarve nga Kraina dhe Kroacia, Beograd, Serbi, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)

#### **Neni 38.**

#### **Shpërbërja e KOMRA-së**

#### **Çlan 40.**

#### **Krijimi i organeve për të mbikëqyrur zbatimin e rekomandimeve të KOMRA-së**

#### **Komentet:**

(...) KOMRA do të duhej ta kryente punën e saj, atë ditë kur e dorëzon raportin me rekomandimet te shtetet, parlamentet, por **nuk e themi se kush do ta vazhdojë monitorimin**. (Amir Kulagliq, Gratë e Srebrenicës, Srebrenicë, BeH, Konsultimet rajonale më viktimat lidhur me draftin e statutit të KOMRA-së, Sarajevë, 18 shtator, 2010.)